



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, dhe në zbatim të vendimit të Kuvendit të Komunës nr.01/016-42280 dt.27.04.2023, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

**V E N D I M**

për

**mbështetje financiare për subvencionimin e aktivitetit të Klubit të Volejbollit "Drita"  
(Meshkujt) nga Gjilani**

1. Me këtë vendim lejohej pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **10.000,00 €** (dhjetëmijë euro) për aktivitetet e Klubit të Volejbollit "Drita" (Meshkujt) nga Gjilani.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor-subvencione – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Mjetet derdhen në xhirollogarinë bankare të Klubit të Volejbollit "Drita"(Meshkujt) [Redacted]
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është marrëveshja për subvencionim dhe vendimi i KK nr.01/016-42280 të dt.27.04.2023.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.


**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfituesit
- DKRS, DBF dhe
- Arkivit

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyëni**





**KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI**

## **MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM**

**ndërmjet**

**Komunës së Gjilanit si autoritet publik**

**dhe**

**Klubi i volejbollit “Drita”(M) nga Gjilani, përfitues**

**Gjilan, 2023**

**Neni 1**  
**Qëllimi i marrëveshjes**

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për subvencionimin e aktivitetit të Klubit të volejbollit "Drita"(M).
2. Marrëveshja është lidhur sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/2018,01 nr. 016-28468 të dt. 22.03.2018. (Neni 13 dhe neni 22 paragrafi 1.1).

**Neni 2**  
**Vlera e Subvencionimit**

Vlera e subvencionimit sipas nenit 1 paragrafi 1 të kësaj marrëveshje është **10.000,00 € (dhjetëmijë euro)** dhe pagesa bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione –Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 3**  
**Obligimet e palëve**

1. **Obligimet e përfituesit të subvencionit janë:**
  - 1.1. Mjetet e marra, përfituesi do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet siç u cekë më lartë.
  - 1.2. Përfituesi duhet të raportojë tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
2. Përfituesi duhet të sjellë tek Komuna e Gjilanit:
  - 2.1. Raportin narrativ (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
  - 2.2. Kopje të faturave.
  - 2.3. Njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit

**Neni 4**

1. **Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:**
  - 1.1. Obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje t'ia transferoj në xhirrollogarinë bankare të përfituesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
  - 1.2. Bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

**Neni 5**  
**Afatet kohore**

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

**Neni 6**  
**Shkëputja e marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:
  - 1.1. Tejkallimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
  - 1.2. Marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
  - 1.3. Shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
  - 1.4. Mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

**Neni 7**  
**Kthimi i mjeteve**

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve, përfituesi është i obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

**Neni 8**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

**Neni 10**

Marrëveshja është përpiluar në 4 kopje të njëjta ku se cila palë do të marrë nga dy kopje.

**Komuna e Gjilanit**  
**Alban Hyseni, Kryetar**



**Besnik Veseli**

---